



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 88
Prishtinë, më 29 tetor 2009

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 TETOR DHE 2 NËNTOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, ndërsa bashkëkryesues ishte Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai i njoftoi deputetët se në seancën e mëparshme, të datës 13 tetor 2009, në mungesë të kuorumit, është shtyrë votimi i Raportit vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, andaj, propozoi që të radhitet si pikë e rendit të ditës, pas pyetjeve parlamentare.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit.

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 e 17 tetor 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Civil,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare,
9. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend më 30 shtator 2009,
11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi, me mbështetje të deputetëve tjerë, për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës,
13. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 e 17 tetor 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 e 17 shtator 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi**, parashtroi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me gjendjen e rëndë të pensionistëve në Kosovë dhe rritjen e pensioneve për ta.

Në mungesë të Kryeministrit, ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj-Bujupi .

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi**, parashtroi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me veprimet e Qeverisë në drejtim të uljes së kamatave nga ana e bankave.

Në mungesë të Kryeministrit, ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj-Bujupi .

Deputeti **Riza Smaka**, parashtroi pyetje për ministrin **Ahmet Shala** lidhur me pikëpamjet e Ministrisë që ai drejton për krijimin e rezervave shtetërore.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtroi pyetje për ministren **Nekibe Kelmendi** lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mungesën e Ligjit të punës në vendin tonë.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Naim Rrustemi**, parashtroi pyetje për ministrin **Ahmet Shala** lidhur me punësimet pa konkurs, kohë më parë, në ndërmarrjet publike.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti **Naim Rrustemi**, parashtroi pyetje për ministren **Nekibe Kelmendi** lidhur me kthimin e të punësuarve shqiptarë në vendet e tyre të punës në Burgun e Mitrovicës dhe se a ka ndonjë të burgosur shqiptar në atë burg, që prej 17 shkurtit 2008.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputetja **Nerxhivane Dauti**, parashtroi pyetje për ministrin **Ahmet Shala** lidhur me kohën e procedimit të Projektligjit për ndihmën shtetërore në Kuvendin e Kosovës.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja **Nurishahe Hulaj**, parashtroi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me fazën e procedimit të Projektligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor dhe mundësinë që ky projektligj të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2009.

Në mungesë të Kryeministrit, ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala lidhur me kapitalin e PTK-së, në shumën prej 200 milion euro, të cilin Qeveria e Kosovës ia ka marrë me rastin e rishikimit të buxhetit për gjashtëmujorin e parë.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Kryetari, në vijim i ftoi deputetët për procedimin me votim të Raportit vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, nga seanca plenare e datës 13 tetor 2009.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,

Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, bashkë me Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi ministrin e Administratës Publike z. Arsim Bajrami që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Ministri **Arsim Bajrami** tha se pas krijimit të rrethanave të reja në Kosovë, ky projektligj paraqet një domosdoshmëri për Shërbimin Civil. Ky projektligj rregullon statusin e shërbyesve civilë në organet e administratës shtetërore, në nivelin lokal dhe atë qendror. Në vazhdim tha se me këtë projektligj ndahen shërbyesit e fushave të tjera, siç janë p.sh. shëndetësia, arsimi, policia, pjesëtarët e FSK-së, si dhe të emëruarit politikë. Ky projektligj po ashtu i definon dy kategori të mëdha, siç janë; shërbyesit civilë të karrierës dhe ata jo të karrierës, potencoi ministri. Ai më tutje shpjegoi se shërbyesit civilë të karrierës projektligji në fjalë i klasifikon në katër kategori kryesore: 1. nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, 2. nëpunës civilë të nivelit drejtues, 3. nëpunës civilë të nivelit ekzekutues dhe profesional dhe 4. nëpunës civilë të nivelit administrativ.

Projektligji në fjalë e definon edhe çështjen e emërimeve të larta në Shërbimin Civil, pastaj e përkufizon Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës si organ për monitorimin e Shërbimit Civil që nga rekrutimi deri te avancimi në pozita të larta të nëpunësve civilë, tha ministri. Ky projektligj është i harmonizuar edhe me Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë dhe kemi pasur një bashkëpunim me FMN-në, Sindikatat dhe faktorë tjerë ndërkombëtarë në Kosovë nga kjo fushë. Ministri, në fund, i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvie Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Gjylnaze Sylja, Naim Rustemi, Melihate Tërmmkolli, Naim Maloku, Rita Hajzeraj, Hajredin Hyseni dhe Esat Brajshori, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë

Kryesuesi ftoi ministrin e **Administratës Publike** z. Arsim Bajrami që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Ministri **Arsim Bajrami** tha se ky projektligj rregullon sistemin e pagave, të shtesave dhe të kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë dhe niset nga definimi që Projektligji për shërbyesit civilë parasheh sistemin e gradimit për ta.

Në vazhdim, tha se me këtë projektligj përcaktohet paga bazë dhe paga shtesë, kurse vlerën e koeficientit e cakton Qeveria e Kosovës.

Kostoja financiare për këtë projektligj do të ketë rritje pas dy vjetësh, sepse ngritja nga një koeficient në koeficientin tjetër më të lartë bëhet pas dy vjetësh të hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë, theksoi ministri.

Ministri, në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Naim Rustemi, Vezira Emrush, Gjylnaze Sylja dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për pagat e shërbyesve civilë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se kompletimi në fushën e legjislacionit kërkon edhe ruajtjen e identitetit arsimor, gjuhësor e kulturor të pjesëtarëve në mërgatë dhe lidhshmërinë e tyre me shtetin e Kosovës.

Ky projektligj parasheh edhe krijimin e Agjencisë për Mërgatën, që do ta koordinonte punën me qendrat kulturore të Kosovës për Mërgatën, të cilat do të themelohen në shtetet që janë në interes të Mërgatës së Kosovës, tha zëvendëskryeministri.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, Agim Veliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Drita Kadriu në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmire Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Mark Krasniqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Mimoza Ahmetaj, Sanije Aliaj, Ibrahim Makolli, Riza Smaka, Armend Zemaj, Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni, Arsim Rexhepi, Fatmir Rexhepi dhe Berim Ramosaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,

Kundër-----1,

Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Mërgatën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se me këtë projektligj krijohet infrastruktura ligjore për financimin e subjekteve politike. Projektligji rregullon mënyrën e financimit të subjekteve politike, pastaj mbikëqyrjen dhe raportimin për shpenzimin e të ardhurave nga ana e subjekteve politike.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për financimin e subjekteve politike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, si dhe deputetët: Zef Morina, Kaqusha Jashari, Bajram Kosumi, Gjylnaze Sylja, Hydajet Hyseni dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----3,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Kryesuesi ftoi ministrin Zenun Pajaziti që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Ministri **Zenun Pajaziti** tha se në hartimin e këtij projektligji kemi pasur mbështetjen e mekanizmave ndërkombëtarë. Projektligji i cakton të drejtat, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale, potencoi ministri Pajaziti. Më tej tha se fushëveprimi i këtij projektligji ka të bëjë edhe me zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës.

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale është ndër ligjet e fundit që janë pjesë e integritimeve evropiane dhe pjesë me rëndësi për liberalizimin e vizave, tha ai.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvie Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anita Morina - Saraçi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputetët: Adem Hajdaraj, Ibrahim Makolli dhe Sabri Hamiti, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,

Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritime Evropiane që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se qëllimi kryesor i këtij projektligji është ofrimi i shërbimit universal të shërbimeve postare. Projektligji parasheh krijimin e autoritetit rregullator të Agjencisë Postare, rolin dhe detyrat e operatorit postar, tha ai.

Zëvendëskryeministri në vijim shpjegoi se në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë të MTPT-së dhe grupe të tjera. Projektligji në fjalë nuk do të ketë implikime buxhetore dhe është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian nga kjo fushë, përfundoi ai.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për shërbimet postare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha - Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputeti Riza Smaka, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për shërbimet postare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur

Kryesuesi ftoi raportuesin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ta marrë fjalën.

Ramadan Gashi tha se Komisioni, për t’i përmbushur detyrat për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë ka vizituar disa institucione, siç janë: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Gjykata Komunale në Prizren, Qendra Edukative në Lipjan dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

Në vijim, ai tha se komisioni ka nxjerr edhe rekomandimet e veta, të cilat janë paraqitur në raport.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** fillimisht e falënderoi komisionin për punën e bërë dhe tha se i përkrah në tërësi Rekomandimet e Komisionit. Në vijim tha se si Ministri jemi në përfundim të Projektligjit për të mitur, që tani quhet Kodi për të mitur, i cili këto ditë pritet të dërgohet në Qeveri. Ajo potencoi pastaj edhe koston shumë të lartë financiare të këtij projektligji, duke e ilustruar këtë me ndërtimin e objekteve për fëmijët me të meta mendore etj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, si dhe deputetja Gjylnaze Syla, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur.
2. Ngarkohet Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë që t'i zbatojnë rekomandimet nga Raporti i cekur në paragrafin një (1) të këtij vendimi dhe Kuvendit t'i raportojnë për zbatimin e tyre.

Kryetari propozoi që seanca plenare për ditën e sotme t'i mbyllë punimet, kurse pikat tjera të rendit të ditës të shqyrtohen në vazhdimin e seancës plenare, më 2 nëntor 2009, në orën 10:00.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit.

Kryetari i mbylli punimet e seancës në orë 17; 55 minuta.

E hëne, 2 nëntor 2009, ora 10:00 **Vazhdimi i seancës plenare**

Seancën plenare e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kurse i ndihmoi anëtari i Kryesisë, **Eqrem Kryeziu**.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.
Ai tha se në vazhdim Kuvendi ka në rend dite pikën e 10-të:

10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend më 30 shtator 2009

Kryetari ftoi raportuesin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, që para deputetëve të paraqet arsyeshmërinë e rekomandimit.

Et'hem Çeku tha se Komisioni në fjalë ka rishqyrtuar amendamentin 14 në nenin 22 të Projektligjit për gazin natyror, të miratuar në Kuvend, më 30 shtator 2009, dhe i ka rekomanduar Kuvendit përmirësimin e nenit 22 të Ligjit për gazin natyror, respektivisht rikthimin e tekstit të nenit 22 të Projektligjit për gazin natyror.

Pasi që nuk pati të paraqitur për diskutim as nga grupet parlamentare, as nga komisionet parlamentare dhe as nga deputetët, Kryetari e hodhi në votim miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend më 30 shtator 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Rekomandimi Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend, më 30 shtator 2009.
2. Lejimi i korigjimeve nga paragrafi një (1) i këtij vendimi ka të bëjë me rikthimin e tekstit të amendamentit katërmbdhjetë (14) në nenin njëzetedy (22) të Projektligjit për gazin natyror.
3. Obligohet Departamenti Ligjor që ta korigjojë tekstin e Ligjit për gazin natyror, sipas Rekomandimit të komisionit funksional dhe të paragrafit dy (2) të këtij vendimi.

11. Shqyrtimi i Mocionit së deputetit Arsim Rexhepi, me mbështetje te deputetëve

tjerë, për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Mocionit që para deputetëve të Kuvendit të paraqet arsyeshmërinë e kërkesës.

Deputeti **Arsim Rexhepi** tha se janë 43 deputetë të cilët kanë nënshkruar kërkesën për të hetuar parregullsitë në Radio-Televizionin e Kosovës. Ai kërkoi nga Grupet Parlamentare që t'i propozojnë anëtarët për këtë komision hetimor.

Në vijim tha se flet edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe i propozoi dy deputetë për komisionin hetimor, Arsim Rexhepin dhe Armend Zemajn.

Kryetari tha se nga përpjekja e parë për ta themeluar një komision të tillë ka pasur nënshkrime jo origjinale të ndonjë deputeti. Ai kërkoi nga deputetët që tani kanë nënshkruar, se a qëndrojnë prapa nënshkrimeve të tyre, gjithnjë duke dëshiruar që kjo të mos kuptohet si ndërhyrje në punën e RTK-së.

Kryetari në vijim i ftoi shefat e Grupeve Parlamentare që të deklarojnë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se për rastin konkret po e presim Raportin financiar dhe se nuk jemi për themelimin e komisionit hetimor në këtë moment.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se nëse komisioni hetimor nuk do të mund të merret me interferimin e instancave tjera nga jashtë në punën e RTK-së, atëherë nuk do t'a mbështesim themelimin e një komisioni të tillë.

Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se për shkak të mënyrës së ardhjes së kësaj kërke, pastaj tërheqjes së kërkesës së njejtë kohë më parë nga shqyrtimi, si dhe të ndërhyrjeve nga jashtë, ne si Grup Parlamentar do t'i mbajmë rezervat tona lidhur me themelimin e një komisioni të tillë.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se si Grup Parlamentar i kemi rezervat tona lidhur me këtë çështje, sepse shumica e arsyeve që përmenden janë të pagjetura. Në vijim tha se ky komision nuk do të ishte mesazh i mirë për Kosovën.

Në fund, tha se një deputet i AKR-së thotë se nuk e ka nënshkrimin autentik në listën e deputetëve nënshkrues.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se meqenëse Bordi i ri i RTK-së është zgjedhur vetëm para disa ditëve, është mirë t'i jepet kohë këtij Bordi të trogohet me punë dhe se asnjë deputet i Grupit Parlamentar “7+” nuk e ka nënshkruar listën në fjalë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë edhe deputetët: Numan Baliq, Naim Maloku, Armend Zemaj, Gani Koci, Riza Smaka dhe Gjylnaze Sylaj, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e deputetit Arsim Rexhepi, me mbështetje të deputetëve tjerë, për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 9,
Kundër----- 19,
Abstenime----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Nuk miratohet propozimi i deputetit Arsim Rexhepi, i mbështetur dhe nga disa deputetë të tjerë, për formimin e Komisionit parlamentar hetimor për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës.

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Kryetari ftoi raportuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë Raportin me Rekomandime.

Ibrahim Makolli tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar propozimin e ministres së Drejtësisë dhe për çdo kandidat të propozuar kemi ardhur në përfundim, si në vijim: 1. Për kandidatin Rustem Qehaja, nuk ka pengesa ligjore për t'u emëruar në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës,

2. Për kandidatin Ruzhdi Berisha, propozimi për t'u emëruar në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës nuk është në pajtim me ligjin. Kërkohet nga ministria e Drejtësisë që të bëjë propozim tjetër.

3. Për kandidatin Bardhyl Hasanpapaj, propozimi për t'u emëruar në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës, i plotëson kushtet ligjore, por nuk është shtetas i Republikës së Kosovës.

4. Për të emëruarën Ilirjani Islami, kërkohet nga Ministria e Drejtësisë të propozojë kandidat tjetër pasi që e njejta është emëruar gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, që sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk mund të ushtrojë funksion tjetër publik ose profesional, për të cilin shpërblehet me pagesë.

Nekibe Kelmendi në lidhje me propozimet e bëra nga Ministria e Drejtësisë, për çshtjen në fjalë tha se ato janë të bazuara në ligj dhe se nuk kemi konflikt të interesit. Ajo në vazhdim citoi nene të Ligjit për Provimin e Jurisprudencës, për të konstatuar se pyetës i lëndës mund të jetë ai që ka specializim nga kjo lëmi.

Për kandidatin Ruzhdi Berisha tha se i plotëson kriteret ligjore pasi që ka 13.7 vjet përvojë pune.

Për kandidatin Bardhyl Hasanpapaj tha se si shkak për mospranim në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës përmendet fakti se ai nuk është shtetas i Kosovës, por ligji askund nuk e thekson se duhet të jetë shtetas i Kosovës.

Ndërsa për kandidaten Ilirjania Islami tha se kjo nuk është punëtore e Ministrisë së Drejtësisë dhe se nuk kemi konflikt intetresi.

Në fund, ajo i ftoi deputetët që t'i votojnë kandidatët Rustem Qehaja, Ruzhdi Berisha dhe Bardhyl Hasanpapaj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Kolë Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, si dhe deputetët, Armend Zemaj, Rita Hajzeraj, Adem Hajdaraj, Naser Rugova, Vezira Emrush, Nekibe Kelmendi, Myfera Shinik, Numan Baliq, Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Hydajet Hyseni dhe Hajredin Kuçi, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari kërkoi nga shefat e Grupeve Parlamentare që të deklarohen rreth mënyrës së votimit të Rekomandimeve të Komisionit për Legjislacin dhe Gjyqësi.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha që Rekomandimet të votohen një nga një.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se duhet të votohet sipas ligjit.

Grupi Parlamentar i AAK-së, nuk u prononcua.

Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha që Rekomandimet të votohen një nga një.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha që Rekomandimet të votohen një nga një.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha që Rekomandimet të votohen një nga një.

Grupi Parlamentar SLS, nuk u prononcua.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari i hodhi në votim një nga një Rekomandimet e Komisionit për Legjislacin dhe Gjyqësi.

Propozimi i parë për votim ishte ai për kandidatin Rustem Qehaja

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----4,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

1. Rustem Qehaja emërohet zëvendësanëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, për lëndën E Drejta Tregtare.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës zgjat dy (2) vjet.

Propozimi i dytë për votim ishte ai për kandidatin Bardhyl Hasanpapaj
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----15,
Kundër-----35,
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk mbështeti propozimin për emërimin e z. Bardhyl Hasanpapaj anëtar të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

Propozimi i tretë për votim ishte ai për kandidatin Ruzhdi Berisha
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----21,
Kundër-----29,
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk mbështeti propozimin për emërimin e z. Ruzhdi Berisha anëtar të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

13. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se mbi bazën e organizimit të ri të strukturës dhe të numrit të anëtarëve të komiseve parlamentare, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, Grupet Parlamentare kanë bërë propozimet për anëtarë në tri komisionet e reja, si dhe ristrukturimin e anëtarëve në 13 komisionet ekzistuese.

Ai tha se mbi bazën e këtyre propozimeve është hartuar edhe Propozim-vendimi për përbërjen e plotë të komiseve parlamentare.

Për këtë pikë diskutuan këta deputetë: Slobodan Petroviq, Branislav Grbiq, Hydajet Hyseni, Numan Baliq, Zylfije Hundozi, Armend Zemaj, Gani Koci, Dragisha Miriq dhe Ibrahim Makolli, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----10,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve në gjashtëmbëdhjetë (16) komisione parlamentare

I. Anëtarët e komisioneve parlamentare emërohen, si vijon:

1. Komisioni për Buxhet e Financa:

1. Gani Koci, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Naser Osmani, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK-së,
3. Kosara Nikolić, zëvendëskryetare e dytë, nga GP i SLS-së,
4. Safete Hadërgjonaj, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Hajdin Abazi, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Armend Zemaj, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Myrvete Pantina, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Haki Shatri, anëtar, nga GP i AAK-së,
9. Suzan Novobrdaliu, anëtare, nga GP i AKR-së,
10. Besa Gaxherri, anëtare, nga GP i LDD-së,
11. Müfera Şinik, anëtare, nga GP “ 7+”,
12. Xhevdet Neziraj, anëtar nga GP i AAK-së.

2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim :

1. Bojan Stojanović, kryetar, nga GP i SLS-së,
2. Sanije Aliaj, zëvendëskryetare e parë, nga GP i LDK-së,
3. Müfera Şinik, zëvendëskryetare e dytë, nga komuniteti turk,
4. Zafir Berisha, anëtar nga GP i PDK-së,
5. Kosara Nikolić, anëtare, nga komuniteti serb,
6. Sadik Idriz, anëtar, nga komuniteti boshnjak,
7. Numan Baliq, anëtar, nga komuniteti boshnjak,
8. Hafize Hajdini, anëtare, nga komuniteti ashkali,
9. Hetem Arifi, anëtar, nga komuniteti ashkali,
10. Zylfi Merxha, anëtar, nga komuniteti rom,
11. Mursejl Haljilji, anëtar, nga komuniteti goran,

12. Enis Kervan, anëtar, nga komuniteti turk,
13. Xhevdet Neziraj, anëtar, nga komuniteti egjiptian.

3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi:

1. Bahri Hyseni, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Adem Salihaj, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDD-së,
3. Vladimir Todoroviq, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së
4. Ramadan Gashi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Selvije Halimi, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Kolë Berisha, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Armend Zemaj, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Bajram Kosumi, anëtar, nga GP i AAK-së,
9. Ibrahim Makolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
10. Adem Hajdaraj, anëtar, nga GP i LDK-së,
11. Mufera Sinik, anëtare, nga GP “7+” .

4. Komisioni për Integritet Evropian:

1. Zylfije Hundozi, kryetare, nga GP i AAK-së,
2. Bujar Bukoshi, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK-së,
3. Džezair Murati, zëvendëskryetar i dytë, nga GP “7+”,
4. Edita Tahiri, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Nait Hasani, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Fatmir Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Njomza Emini, anëtare, nga GP i AKR-së,
8. Naser Rugova, anëtar, nga GP i LDD-së,
9. Murselj Haljilji, anëtar, nga GP i SLS-së.

5. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione:

1. Ismet Beqiri, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Nerxhivane Dauti, zëvendëskryetare e parë, nga GP i PDK-së,
3. Radmila Vujoviq, zëvendëskryetare e dytë, nga GP i SLS-së,
4. Hajredin Hyseni, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Luljeta Shehu, anëtare, nga GP i LDK-së,
6. Danush Ademi, anëtar, nga GP i AAK-së,
7. Ibrahim Makolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
8. Drita Maliqi, anëtare, nga GP i LDD-së,
9. Špresa Murati, anëtare, nga GP “7+”.

6. Komisioni për Punë të Jashtme:

1. Sabri Hamiti, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Xhavit Haliti, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Enis Kervan, zëvendëskryetar i dytë nga GP “7+”,

4. Ramë Buja, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Lutfi Haziri, anëtar, nga GP i LDK-së,
6. Ardian Gjini, anëtar, nga GP i AAK-së,
7. Ibrahim Gashi, anëtar, nga GP i AKR-së,
8. Nexhat Daci, anëtar, nga GP i LDD-së,
9. Slobodan Petroviq, anëtar, nga GP i SLS-së.

7. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport:

1. Agim Veliu, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Drita Kadriu, zëvendëskryetare e parë, nga GP i PDK-së,
3. Enis Kervan, zëvendëskryetari i dytë, nga GP “7+”,
4. Memli Krasniqi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Arsim Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
6. Donika Kadaj-Bujupi, anëtare, nga GP i AAK-së,
7. Heset Cakolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
8. Mark Krasniqi, anëtar, nga GP i LDD-së,
9. Dragan Dimiq, anëtar, nga GP i SLS-së.

8. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion :

1. Myzejene Selmani, kryetare, nga GP i AKR-së,
2. Et’hem Çeku, zëvendëskryetar i parë, nga GP i AAK-së,
3. Slobodan Petroviq, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Kaqusha Jashari, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Nerxhivane Dauti, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Sala Berisha-Shala, anëtare, nga GP i PDK-së,
7. Fatmir Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Zef Morina, anëtar, nga GP i LDK-së,
9. _____, nga GP i LDK-së,
10. Qamile Morina, anëtare, nga GP i LDD-së,
11. Müfera Şinik, anëtare, nga GP “7+”.

9. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor :

1. Naser Rugova , kryetar, nga GP i LDD-së,
2. Naim Maloku, zëvendëskryetar i parë, nga GP i AAK-së,
3. Zylfi Merxha, zëvendëskryetar i dytë, nga GP “7+”,
4. Berat Luzha, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Elheme Hetemi, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Selvije Halimi, anëtare, nga GP i PDK-së,
7. Ali Lajçi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Zef Morina, anëtar, nga GP i LDK-së,
9. Myrvete Pantina, anëtare, nga GP i LDK-së dhe

10. Heset Cakolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
11. Dragisha Miriq, anëtar, nga GP i SLS-së

10. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale:

1. Sadik Idriz, kryetar, nga GP “7+”,
2. Rita Hajzeraj, zëvendëskryetare e parë, nga GP i AKR-së,
3. Mursel Halili, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Teutë Hadri, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Flora Brovina, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Nurisha Hula, anëtare, nga GP i LDK-së,
7. Bujar Bukoshi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Gjylnaze Sylaj, anëtare, nga GP i AAK-së,
9. Qamile Morina anëtare, nga GP i LDD-së.

11. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media:

1. Esat Brajshori, kryetar, nga GP i AKR-së,
2. Hajredin Hyseni, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Shpresa Murati, zëvendëskryetare e dytë, nga GP “7+”,
4. Hajdin Abazi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Melihate Tërmetkollari, anëtare, nga GP i LDK-së,
6. Ali Lajçi, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Rasim Selmanaj, anëtar, nga GP i AAK-së,
8. Synavere Rysha, anëtare, nga GP i LDD-së,
9. Dragan Dimiq, anëtar, nga GP i SLS-së.

12. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri:

1. Rrustem Mustafa, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Suzan Novobrdaliu, zëvendëskryetare e parë, nga GP i AKR-së,
3. Bojan Stojanoviq, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Zafir Berisha, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Eqrem Kryeziu, anëtar, nga GP i LDK-së,
6. Melihate Termkollari, anëtare, nga GP i LDK-së,
7. Shkumbin Demalijaj, anëtar, nga GP i AAK-së,
8. Lulzim Zeneli, anëtar, nga GP i LDD-së,
9. Zylfi Merxha, anëtar, nga GP “7+”.

13. Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit:

1. Hydajet Hyseni-Kaloshi, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Kolë Berisha, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK-së,
3. Džezair Murati, zëvendëskryetar i dytë, nga GP “7+”,
4. Ramadan Gashi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Fatmire Berisha, anëtare, nga GP i LDK-së,
6. Ahmet Isufi, anëtar, nga GP i AAK-së,
7. Suzan Novobrdaliu, anëtare, nga GP i AKR-së,
8. Besa Gaxherri, anëtare, nga GP i LDD-së,

9. Radmilla Vojoviq, anëtare, nga GP i SLS-së.

14. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike:

1. Haki Shatri, kryetar, nga GP i AAK-së,
2. Safete Hadergjonaj ,zëvendëskryetare e parë, nga GP i PDK-së,
3. Kosara Nikoliq, zëvendëskryetare e dytë, nga GP i SLS-së,
4. Gani Koci, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Arsim Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
6. Anita Morina, anëtare, nga GP i LDK-së,
7. Riza Smaka, anëtar, nga GP i AKR-së
8. Synavere Rysha, anëtare, nga GP i LDD-së,
9. Enis Kervan, anëtar, nga GP “7+”.

15. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë:

1. Gani Geci, kryetar, nga GP i LDD-së,
2. Gani Buçinca, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Sadik Idriz, zëvendëskryetar i dytë, nga GP “7+”,
4. Mimoza Ahmetaj, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Eqrem Kryeziu, anëtar, nga GP i LDK-së,
6. Lutfi Haziri , anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Ibrahim Selmanaj, anëtar, nga GP i AAK-së,
8. Esat Brajshori, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Dragan Dimiq, anëtar, nga GP i SLS-së.

16. Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës:

1. Berim Ramosaj, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Gjylnaze Syla, zëvendëskryetare e parë, nga GP i AAK-së,
3. _____, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Ramadan Avdiu, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Nait Hasani, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Adem Hajdaraj, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Adem Salihaj, nga GP i LDD-së,
8. Rita Hajzeraj, anëtare, nga GP i AKR-së,
9. Zylfi Merxha , anëtar, nga GP “7+”.

II. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr.03-V-010, dt. 31 janar 2008.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 12:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**